



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

Nr. 2505. prot

Dt. 27.04.2020

URDHËR

Nr. 135, Datë 27.04.2020

“PËR

**PËRCAKTIMIN E DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM PËR T’U REGJISTRUAR  
SI NDIHMËSPËRMBARUES”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 19, pika 10, të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”,

URDHËROJ:

1. Ndihmëspërmbaruesit regjistrohen në Regjistrin e krijuar dhe të administruar nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë.
2. Regjistri përmban të dhëna mbi individët, që kërkojnë të regjistrohen si ndihmëspërmbarues gjyqësor privat. Ndihmëspërmbaruesi duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:
  - a. të jetë shtetas shqiptar;
  - b. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
  - c. të ketë përfunduar programin e ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi brenda vendit, ose diplomë të njësuar me të, apo të ketë përfunduar studimet universitare për drejtësi jashtë vendit, të njohur dhe njësuar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;
  - ç. të ketë përfunduar me sukses programin e detyrueshëm 1-vjeçar të trajnimit fillestar pranë Qendrës së Trajnimit në Dhomën Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë;
  - d. të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë:
    - i) për një vepër penale të kryer me dashje, për të cilën nuk është rehabilituar;
    - ii) për një vepër penale të kryer me pakujdesi, për të cilën nuk është rehabilituar dhe që cenon figurën dhe integritetin e profesionit të përmbaruesit gjyqësor;
    - iii) për një vepër penale të kryer me dashje, për të cilën është rehabilituar, kur vepra penale cenon figurën dhe integritetin e profesionit të përmbaruesit gjyqësor;
  - dh. të mos jetë shkarkuar nga ushtrimi i detyrës ose funksionit publik, me vendim të organit kompetent, që ka marrë formë të prerë.

e. të jetë në marrëdhënie pune me kohë të plotë me një përmbarues gjyqësor privat ose zyrë të përmbarimit privat, si ndihmëspërmbarues për një periudhë jo më të vogël se 2 vjet, pas kryerjes së trajnimit të detyrueshëm fillestar;

3. Personi i interesuar, për t'u regjistruar si ndihmëspërmbarues gjyqësor, depoziton pranë Ministrisë së Drejtësisë dokumentacionin e nevojshëm për administrimin e të dhënave në vërtetimin të përbushje së kushteve sipas pikës 2, të këtij urdhri. Dokumentacioni i nevojshëm përmban:

a. Fotokopjen e dokumentit të identifikimit (pasaportë apo letërnjoftim ID);

b. Vërtetimin nga organet e pushtetit vendor lidhur me vendbanimin;

c. Fotokopjen e noterizuar të diplomës së studimeve universitare për drejtësi brenda vendit, ose diplomë të njësuar me të, apo të diplomës së studimeve universitare për drejtësi jashtë vendit, të njohur dhe njësuar, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, dhe të certifikatës së notave;

ç. Vërtetimin për fillimin përfundimin e programit të detyrueshëm të trajnimitfillestar, Çertifikatën e përfundimit me sukses së programit të detyrueshëm 1-vjeçar të trajnimit fillestar pranë Qendrës së Trajnimit;

d. Kopjen e kontratës të lidhur mes tij dhe zyrës përmbarimore/përmbaruesit gjyqësor privat me të cilët ka lidhur kontratë punë me kohë të plotë, brenda 15 ditëve nga momenti i lidhjes së saj.

dh. Referencë/vërtetim nga përmbaruesi gjyqësor privat për periudhën e qëndrimit.

ç. Formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore.

d. Vërtetimin nga gjykata dhe prokuroria e vendbanimit se nuk është subjekt në proces për vepra penale;

dh. Fotokopjen e noterizuar të librezës së punës (nëse ka).

4. Dokumentacioni depozitohet pranë Ministrisë së Drejtësisë në format shkresor, përmes shërbimit postar.

5. Struktura përgjegjëse pas verifikimit të dokumentacionit të përcaktuar në pikën 3 të këtij urdhri, bën regjistrimin e të dhënave në përputhje me parashikimet nenit 23 të ligjit 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”.

6. Dokumentacioni i administruar mbahet në dosjen personale, pranë arkivit të Ministrisë së Drejtësisë, e cila krijohet dhe pasurohet me dokumentacionin e nevojshëm nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë. Dosja personale numërohet në përputhje me numrin rendor që i korrespondon ndihmës përmbaruesit në Regjistrin e administruar nga strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë.

7. Dokumentacioni i ndodhur në dosje, i cili pasqyron në mënyrë kronologjike të gjithë procesin e ndjekur nga ndihmës përmbaruesi në përputhje me legjislacionin në fuqi, numërohet dhe pasqyrohet në fletën e pasqyrës së dokumenteve të dosjes të ngjitur në pjesën e brendshme të kapakut të saj ose të bashkëlidhur në kapak me vulën e Ministrisë së Drejtësisë.

8. Dosja e ndihmës përmbaruesit përmban dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Fotokopjen e dokumentit të identifikimit (pasaportë apo letërnjoftim ID);

b) Vërtetimin nga organet e pushtetit vendor lidhur me vendbanimin;



- c) Fotokopjen e noterizuar të diplomës së studimeve universitare për drejtësi brenda vendit, ose diplomë të njësuar me të, apo të diplomës së studimeve universitare për drejtësi jashtë vendit, të njohur dhe njësuar, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, dhe të çertifikatës së notave;
- ç) Formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore, i plotësuar;
- d) Vërtetimin nga gjykata dhe prokuroria e vendbanimit se nuk është subjekt në proces për vepra penale;
- e) Fotokopjen e noterizuar të librezës së punës (kur ka qenë punëmarrës);
- ë) Kopjen e kontratës të lidhur mes tij dhe zyrës përmbarimore/përmbaruesit gjyqësor privatme të cilët ka lidhur kontratë punë me kohë të plotë, datën e fillimit të marrëdhënies së punës pranë përmbaruesit gjyqësor privat dhe/ose zyrës së përmbarimit privat;
- f) Kopjen e aktit të miratimit si ndihmës përmbarues;
- g) Referencën e lëshuar nga përmbaruesi, për periudhën e qëndrimit si ndihmës;
- gj) të dhëna mbi fillimin përfundim të programit të detyrueshëm të trajnimit fillestar, Çertifikatën e përfundimit me sukses të programit të detyrueshëm 1-vjeçar të trajnimit fillestar pranë Qendrës së Trajnimit;
- h) përmbaruesin përkatës që e ka regjistruar si kandidat për ndihmëspërmbarues;
- i) Kur është rasti, njoftime të ndryshme nga zyra përmbarimore/përmbaruesi gjyqësor privat, dokumente që pasqyrojnë arsye të ndërprerjes ose shtyrjes së periudhës së qëndrimit si ndihmës etj.

9. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë për zbatimin e këtij urdhri.

10. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Portokollit për ruajtjen e dosjes personale të ndihmëspërmbaruesit gjyqësor dhe njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

*Etilda Gjonaj*

**Etilda Gjonaj (Saliu)**

